

Takimi i 1514-të , 3-5 dhjetor 2024 (DNj)

Të Drejtat e Njeriut

H46-1 Grupi Luli dhe të Tjerët kundër Shqipërisë (Kërkesa Nr. 64480/09)

Momitorimi i ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane

Dokumentet e referencës

DH-DD(2024)239 , DH-DD(2024)1210 , CM/Del/Dhjetor(2022)1451/H46-1

Kërkesa	Çështja	Vendimi i	Përfundimtar në	Treguesi për klasifikimin
64480/09+	LULI DHE TË TJERËT	01/04/2014	01/07/2014	Problem kompleks
10508/02	GJONBOÇARI DHE TË TJERËT	23/10/2007	31/03/2008	
43391/18+	BARA DHE KOLA	12/10/2021	28/02/2022	
22122/08	LACEJ DHE TË TJERËT	29/09/2022	29/09/2022	
72348/11	MULLA	06/07/2023	06/07/2023	
61445/12+	ZEQO DHE SEAT SH.P.K	22/06/2023	22/06/2023	
11254/11	HAMITAJ	20/07/2023	20/07/2023	
31011/09	ILIRIA S.R. L	05/03/2024	05/03/2024	
22493/12	KOKALARI	30/01/2024	30/01/2024	
31018/09	VICKTORIA SH.P.K	22/02/2024	22/02/2024	
18076/12	VJOLA SH.PK DHE DE SH.PK	30/01/2024	30/01/2024	

Përshkrimi i çështjeve

Ky grup çështjesh ka të bëjë me zgjatjen e tepruar të proceseve civile, administrative dhe penale ¹ ndërmjet viteve 1996 dhe 2021. Gjykata Evropiane kritikoi, ndër të tjera, dështimin e sistemit gjyqësor për të menaxhuar siç duhet një shumëfishim të procedurave para gjykatave të ndryshme për të njëjtën çështje dhe për ridërgimin e çështjeve në mënyrë të vazhdueshme në nivele më të ulëta juridiksioni në proceset civile ose penale (shkelje e nenit 6 § 1). Çështjet e *Gjonboçarit dhe të tjerëve* dhe *Bara dhe Kola* kanë të bëjnë gjithashtu me mungesën e një mjeti efektiv ligjor ose joefektivitetin e një mjeti ligjor në rrethana specifike (shkelje të nenit 13).²

Sipas nenit 46 të vendimit *Luli dhe të Tjerët*, Gjykata Evropiane vuri në dukje se zgjatja e tepërt e procedurave u bë një mangësi serioze dhe tregoi nevojën për të miratuar masa të përgjithshme, në veçanti futjen e një mjeti juridik të brendshëm.

Statusi i ekzekutimit

Informacioni i dhënë nga autoritetet në përgjigje të vendimeve të mëparshme të Komitetit është përmbledhur më poshtë (DH-DD(2024)239 dhe DH-DD(2024)1210). Gjithashtu është paraqitur informacioni përkatës i disponueshëm publikisht.

Masat individuale :

Shpërblimi i drejtë i dhënë nga Gjykata Evropiane është paguar në të gjitha çështjet, përveç çështjes së

¹Në Rezolutën Përfundimtare në rastin *Kaciu dhe Kottori* (CM/ResDH(2016)272), Komiteti vuri në dukje se çështja e kohëzgjatjes së gjykimeve penale do të vazhdonte të ndiqej në kuadër të grupit aktual.

²Çështja *Gjonboçari dhe të Tjerët* ka të bëjë edhe me moszbatimin e një vendimi gjyqësor nga ish-Komiteti i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, ndërkohë që çështja *Kokalari* ka të bëjë me procedimet e gjata administrative për shkak të vonesave pranë këtij Komiteti; masat e përgjithshme përkatëse u miratuan në grupin Manushaqe Puto (CM/ResDH(2018)349).

fundit *Iliria S.R.L.*

Në çështjen *Luli dhe të Tjerët*, një nga proceset e brendshme është ende në pritje në Gjykatën e Apelit.

Në çështjen *Bara dhe Kola*, më 27 mars 2023, Gjykata Administrative e Apelit la në fuqi vendimin e shkallës së parë, i cili nuk u ankimua (anikimi *Bara*). Gjykimi për ankimin *Kola* është ende në pritje.

Për sa i përket çështjes *Gjonboçari dhe të tjerët*, autoritetet konsiderojnë se nuk kërkohen masa të mëtejshme individuale, sepse Gjykata Evropiane në një vendim të fundit të papranueshmërisë të marsit 2024 (*Gëzim Boçari kundër Shqipërisë*, Nr. 75984/11) konstatoi se Agjencia e Vlorës u pajtua me shpejtësi me vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 6 mars 2003 duke nxjerrë një vendim mbi kërkesën për kthim të pasurisë.

Gjykimet kanë përfunduar në çështjet *Lacej dhe të Tjerët*, *Mulla, Zeqo dhe Seat Sh.P.K.*, *Hamitaj*, *Iliria S.R.L.*, *Vicktoria Sh.P.K.*, dhe *Vjola Sh.P.K.* dhe *De Sh.P.K* qysh para vendimeve të Gjykatës Evropiane.

Nuk është dhënë asnjë informacion në lidhje me gjykimin në çështjen e fundit *Kokalari*.

Masat e përgjithshme:

A) Ekzaminimi i mëparshëm nga Komiteti i Ministrave

Në dhjetor 2022, Komiteti kërkoi garanci që afati i zgjatur për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve (deri në fund të vitit 2024) do të respektohej dhe se funksionimi i gjyqësorit do të sigurohej ndërkohë, siç rekomandohet nga Komisioni i Venecias. Ai përshëndeti progresin e qëndrueshëm të bërë në plotësimin e vendeve vakante të gjyqtarëve, si rezultat i rivlerësimit kalimtar, i cili ka lejuar që Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë të bëhen funksionale; ai mirëpriti gjithashtu masat e qëndrueshme për të reduktuar numrin e çështjeve të pazgjidhura në Gjykatën e Lartë dhe ritmin e mirë të zgjidhjes së çështjeve në Gjykatën Kushtetuese. Ai u kërkoi autoriteteve, ndër të tjera, të përshpejtojnë emërimin e gjyqtarëve dhe të reduktojnë numrin e çështjeve të pazgjidhura në gjykatat më të prekura (veçanërisht gjykatat e shkallës së dytë) dhe të vlerësojnë nevojën për masa specifike shtesë për reduktimin e çështjeve të pazgjidhura. Komiteti përshëndeti faktin që mjeti i përgjithshëm përshpejtues dhe kompensues është konsideruar së fundmi nga Gjykata Evropiane si efektiv në parim, por vuri në dukje se mbetet për t'u parë nëse mjeti ligjor ka qenë gjithashtu efektiv në praktikë.

Së fundi, kërkoi sqarime mbi arsyet e refuzimit të kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe për përshpejtimin e procedurave, si dhe për një pasqyrë të plotë statistikore të përdorimit dhe ekzaminimit të mjeteve juridike.

B) Masat për të adresuar zgjatjen e tepërt të procedurave gjyqësore

1) Progresi me vettingun e gjyqtarëve dhe magjistratëve të tjerë³

Sipas të dhënave publike të Komisionit Evropian, më 22 tetor 2024⁴, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) (shkalla e parë e procesit të vettingut), ka vlerësuar në total 798 magjistratë, nga 805 (rreth 99 %). Si rezultat, 44,9% e magjistratëve u konfirmuan në detyrë dhe 33,1% u shkarkuan. Procedurat e vettingut u ndërprejnë për 22.8% të magjistratëve për shkak të dorëheqjes (16.02 %) ose detyrimit për t'iu nënshtruar trajnimit (5.9%).

Vendimet e vettingut marrin formë të prerë nëse nuk apelohej ose konfirmohen nga Kolegji i Posaçëm i Apelit. Deri më 22 tetor 2024, ishin 648 vendimet përfundimtare (kundrejt 571 në dhjetor 2023 dhe 336 në 2021), duke përfshirë 296 konfirmime në detyrë; 187 shkarkime; dhe 165 largime (nga të cilat 111 për shkak të dorëheqjeve). Nuk ka informacion të saktë për numrin e ankesave në pritje.

Komisioni Evropian ka vënë në dukje në raportin e tij vjetor 2024 për Shqipërinë se ekziston rreziku i skadimit të afatit të qershorit 2026 të përcaktuar në Kushtetutë për përfundimin e procesit të vettingut përpara se të gjitha çështjet e vettingut të përfundojnë në apel.

³Procesi i vettingut, i nisur në vitin 2017, si pjesë e masave kalimtare për reformimin e gjyqësorit, ku verifikohen kredencialet e të gjithë magjistratëve, është ende në vazhdim. Për detaje mbi këtë proces, shihni Shënimet e përgatitura për takimet e 1377 'CM /Notes/1377/H46-1) dhe 1451 ' (CM/Notes/1451/H46-1).

⁴Shih Komisioni Evropian, Shërbimi Evropian i Veprimtërisë të Jashtëm, Pasqyrë e veprimtarisë së organeve të vettingut deri më 22 tetor 2024

2) Progresi me plotësimin e vendeve vakante të gjyqtarëve

Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) raportoi se në vitin 2023 u plotësuan efektivisht 60.5% të pozicioneve të gjyqtarëve⁵. Në vitin 2023 kishte 247 gjyqtarë (228 në 2022), për një total prej 408 pozicioneve, që paraqet një mungesë prej 161 gjyqtarësh⁶. Sipas raportit të KLGJ, mungesa e gjyqtarëve çoi në ngarkesë shumë të lartë të punës. Gjithashtu, 173 vende për punonjës të administratës gjyqësore mbetën vakante.

Në tetor 2024, autoritetet nënvizuan se KLGJ ka avancuar në plotësimin e vendeve vakante të gjyqtarëve. Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë ("GjL") aktualisht funksionojnë në përbërje të plotë (DH-DD(2024)239). Bazuar në kuotat e miratuara tashmë nga KLGJ, 120 gjyqtarë të rinj pritët t'i bashkohen drejtësisë në tre vitet e ardhshme⁷. Një strategji e KLGJ-së e majit 2024 (shih më poshtë) bën parashikime për arritjen e përbërjes së plotë të gjykatave më të mbingarkuara në 2027 dhe 2028.

Në vitin 2023, gjithsej 16 gjyqtarë tashmë në detyrë janë emëruar, nëpërmjet promovimit ose delegimit, në gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë ku përforsimi ishte i nevojshëm (DH-DD(2024)1210). Gjithashtu, u emëruan 73 gjyqtarë të rinj të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës në 2023 dhe 2024⁸. Në raportin e fundit për Shqipërinë, Komisioni Evropian nënvizoi se pranimit vjetor i magjistratëve nga Shkolla e Magjistraturës është ende i pamjaftueshëm.⁹

3) Masat specifike për të ulur numrin e çështjeve të prapambetura

- Riorganizimi i sistemit gjyqësor: Pas miratimit të Hartës Gjyqësore në vitin 2022¹⁰, KLGJ miratoi gjithsej 60 akte nënligjore, për ngritjen e komisioneve të riorganizimit dhe transferimin e gjyqtarëve¹¹. Përfundoi ristrukturimin e gjykatave dhe ka rishpërndarë të gjithë magjistratët dhe personelin tjetër në dispozicion.

- Strategjia e KLGJ-së e majit 2024: KLGJ-ja miratoi një strategji për uljen e çështjeve të prapambetura (duke përfshirë, ndër të tjera, skenarë për reduktimin e çështjeve të prapambetura nga gjykata, rekomandime dhe një plan veprimi). KLGJ-ja miratoi udhëzimin për hartimin dhe klasifikimin e çështjeve të prapambetura dhe i propozoi Parlamentit ndryshime në legjislacionin përkatës për ligjin procedural. Zbatimi i këtyre dhe masave të tjera është në proces¹². KLGJ-ja gjithashtu paraqiti një raport në Parlament më 29 prill 2024, duke parashtruar nevojën për fonde shtesë për të mundësuar emërimin e magjistratëve të rinj dhe stafit mbështetës.

- Strategjia ndërsektoriale e drejtësisë (2024-2030): Ministria e Drejtësisë ka hartuar një strategji të re të drejtësisë, e cila synon ndër të tjera rritjen e efikasitetit të gjykatave dhe sigurimin e burimeve të nevojshme financiare, njerëzore dhe infrastrukturore për një funksionim efektiv të sistemit të drejtësisë.

- Sistemi i ri i menaxhimit të çështjeve: KLGJ-ja po zhvillon një sistem të ri të menaxhimit të çështjeve (ICMIS) për gjykatat. Grupi i Punës Ndërinstitucional (GPN), në konsultim me Komisionin Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), ekspertët e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë dhe Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Shërbimet e Projekteve (UNOPS), ka përgatitur Udhërrëfyesin për dixhitalizimin e sistemit të drejtësisë dhe një kornizë ndërveprueshmërie për të gjithë sistemin e integruar. Janë miratuar disa akte përgatitore për një sistem të integruar të menaxhimit të çështjeve.

- Harmonizimi i praktikave nga GjL dhe rekrutimi i këshilltarëve ligjorë: GjL ka përmirësuar metodat e punës duke standardizuar aktet procedurale dhe duke rishikuar praktikat administrative. Janë rekrutuar këshilltarë të rinj ligjorë dhe është krijuar një njësi prej 28 këshilltarësh me synim reduktimin e numrit të çështjeve të prapambetura. Aktualisht, GjL po punon për unifikimin e praktikave, nëpërmjet gjykimit të çështjeve të gjykuara në kolegje prej pesë anëtarësh.

- Tërheqja e ankesave: Udhëzimi nr. 1 i Këshillit të Ministrave, datë 26 maj 2022, ka kontribuar në uljen e numrit të të pazgjidhura të çështjeve duke mundësuar tërheqjen nga shteti të apeliemeve që kanë humbur

⁵KLGJ (2024), Raport për gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e KLGJ për vitin 2023

⁶Ky numër është përcaktuar në Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 7818, datë 16.11.2012, "Për numrin e gjyqtarëve për çdo gjykatë të shkallës së parë, të apelit dhe administrative, si dhe për përcaktimin e kompetencës tokësore dhe selisë së gjykatave administrative".

⁷Autoritetet kanë sqaruar megjithatë se këto janë parashikime dhe se siguri i numrit të nevojshëm të gjyqtarëve është një proces kompleks që varet nga çdo kriter dhe faktor (vetting, pension, rezultat i procedimeve disiplinore, dorëheqje).

⁸KLGJ (2024), Raport mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e KLGJ për vitin 2023, cituar më sipër.

⁹Komisioni Evropian (2024) Raporti vjetor për Shqipërinë, f. 31

¹⁰Projekti i përbashkët BE/KiE SEJ IV ka mbështetur me Metodologjinë mbi Hartën Gjyqësore, trajnimin mbi mjetet e CEPEJ-it mbi menaxhimin e kohës gjyqësore dhe gjithashtu ka kontribuar në grupin e punës për reduktimin e lëndëve të pazgjidhura.

¹¹Riorganizimi zvogëloi numrin e gjykatave nga 38 në 20. Gjykatat e riorganizuara filluan punën më: 1 shkurt 2023 (Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm); 1 maj 2023 (13 gjykata të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm); dhe 1 korrik 2023 (dy Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Lushnjë).

¹²Për periudhën 2024 - 2027, dokumenti strategjik i KLGJ-së përcakton objektivat e gjykatave të caktuara, si p.sh.: zgjidhja e të gjitha çështjeve aktualisht në pritje pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm dhe administrativ të Tiranës në 2025/2026, nëse është e ardhura nuk rriten ndjeshëm; duke ulur diferencën e mbetur me 20-30% për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe me 25 % për Gjykatën Administrative të Apelit.

rëndësinë e tyre. Në vitin 2023, nga 468 kërkesa për tërheqje ankesash, 384 ishin nga institucionet publike.

- Ridërgimet e shpeshta të çështjeve në proceset civile dhe penale : Për vitin 2022 dhe 2023 ka pasur rritje të ridërgimeve nga GjL(209 nga 1805 lëndë të shqyrtuara janë kthyer prapa); autoritetet shpjeguan se kjo shifër ishte për shkak të rritjes së konsiderueshme të numrit të përgjithshëm të çështjeve të gjykuara nga ajo gjykatë në dy vitet e fundit. Nuk është dhënë asnjë informacion specifik për numrin e ridërgimeve për gjykim në çështjet civile¹³.

4) Ndikimi i masave

- Funksionimi i Gjykatës Kushtetuese : Gjykimi i çështjeve nga Gjykata Kushtetuese zgjat rreth 8 muaj dhe Gjykata Kushtetuese aktualisht nuk ka çështje të prapambetura.

- Funksionimi i Gjykatës së Lartë : Autoritetet raportojnë një rënie prej 18% në çështjet në pritje (26,058 në janar 2024; 31,827 në 2023 dhe 30,998 në 2022). GjL aktualisht po shqyrton ankimet nga viti 2015-2018, por kategoritë prioritare të çështjeve shqyrtohen më shpejt. Në vitin 2023, çdo gjyqtar i GjL-së kishte një ngarkesë pune prej afro 2084 çështjesh; GjL shqyrtoi mesatarisht 250 çështje në vit për gjyqtar. KLGJ raporton se në vitin 2023, norma e likuidimit¹⁴ për çështjet civile ishte 362.53% (282% në 2022); për çështjet penale ishte 265,17% (193% në 2022) dhe për çështjet administrative ishte 535% (613% në 2022). Në vitin 2022 17 shtet raportuar se kohëzgjatja e gjykimeve¹⁵ ka qenë 2851.2 ditë për çështjet civile, 902.5 ditë për çështjet penale dhe 1584.1 ditë për çështjet administrative.

- Funksionimi i gjykatave të apelit : Numri i çështjeve të prapambetura pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm siç raportohet nga autoritetet u rrit në 37,662 në vitin 2023 (18,013 në 2020; 28,140 në 2021; 31,370 në 2022). Në vitin 2022, norma e likuidimit ishte 66% për çështjet civile dhe tregtare dhe 85% për çështjet penale. ¹⁶Të dhënat e KLGJ-së ¹⁷lejojnë një përfundim se në vitin 2023 norma e likuidimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (i vetmi juridiksion i këtij lloji) ¹⁸ishte 43% për çështjet civile; 73% për çështjet penale; norma mesatare e likuidimit ishte 56.4% (56.7% në 2022). Në vitin 2023, kohëzgjatja mesatare e gjykimit për këtë juridiksion ishte 1,673.4 ditë për të gjitha llojet e çështjeve; ishte 2,790,7 ditë në çështjet civile (1,605 në 2022) dhe 885,2 në çështjet penale (893 në 2022). Në vitin 2023, 31 % e gjyqtarëve ishin efektivisht në detyrë; dhe 69 % e stafit të gjykatës.

Sipas të dhënave të siguruar nga autoritetet, numri i çështjeve në pritje në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë është rritur në 23,056 çështje në vitin 2023 (2,810 në 2020; 15,157 në 2021; 21,166 në 2022). Në vitin 2022, norma e likuidimit ishte 24.4%. Të dhënat e KLGJ-së nxjerrin një përfundim se norma e likuidimit në vitin 2023 ishte 43%. Gjithashtu, në vitin 2023, kohëzgjatja mesatare e gjykimit ishte 5,326,20 ditë (14,6 vjet) (8,650 ditë ose 23,6 vjet në 2022). Tetë nga 13 gjyqtarë ishin në detyrë; dhe 49.5% e stafit të gjykatës ishin në detyrë.

Në vitin 2023, Gjykata Speciale e Apelit për Korrupsion dhe Krim të Organizuar kishte një normë likuidimi prej 103.3%.

- Situata në gjykatat e shkallës së parë : Për 13 gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, çështjet e prapambetura u rritën në 44.181 në vitin 2023 (36.590 në vitin 2021; 40.866 në vitin 2022), nga të cilat 45% (19.911 çështje të prapambetura) Gjykata e Shkallës së Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Të dhënat nga KLGJ tregojnë se shkalla norma mesatare e likuidimit në vitin 2023 ishte 90% për çështjet civile (p.sh. gjykatat e Tiranës dhe Sarandës nën 100% dhe Gjykata e Beratit në 112%) dhe 97% për çështjet penale. KLGJ raporton¹⁹ se në vitin 2023 kohëzgjatja mesatare e gjykimeve ishte 272 ditë për çështjet civile (175 në 2022) dhe 114 ditë për çështjet penale (94 në 2022). Përqindja e gjyqtarëve në detyrë ishte 56% (131.9 gjyqtarë nga 235 pozicione pune të planifikuara)²⁰. Sipas KLGJ-së, ngarkesa mesatare e gjyqtarëve ndryshonte shumë ndërmjet gjykatave, për shkak të dallimeve në vendet vakante të gjyqtarëve.

¹³Në vitin 2018 dhe 2020 respektivisht, autoritetet informuan mbi ndryshimet për të kufizuar ridërgimet për gjykim të paraqitura në Kodin e Procedurës Civile të vitit 2013 (DH-DD(2018)1018) dhe rregullat e KD për ankesat në çështjet penale(DH-DD(2020) 325). Shihni shënime për dhjetorin 2018 (CM/Shënime/1331/H46-1 dhe), si dhe për takimet e qershorit 2020 (CM/Shënime/1377/H46-1).

¹⁴Norma e likuidimit është numri i çështjeve të përfunduara pjesëtuar me numrin e çështjeve të ardhura, i shprehur në përqindje. Një normë nën 100% sugjeron që çështjet e reja po depozitohen me një ritëm më të shpejtë sesa mund të zgjidhen dhe numri i çështjeve të mbetura rritet.

¹⁵Mesatare teorike për kohëzgjatjen e përfundimit të të gjitha çështjeve në pritje. Arrihet duke pjesëtuar çështjet në pritje në fund të një periudhe të caktuar me çështjet e gjykuara për atë periudhë dhe më pas duke shumëzuar rezultatin me 365 për ta shprehur atë në ditë.

¹⁶CEPEJ (2023), Paneli i Ballkanit Perëndimor – Mbledhja e të dhënave 2022, profili i përfuturit - Shqipëri

¹⁷KLGJ, Raporti Vjetor (2023), i cituar më sipër

¹⁸Gjashtë gjykata të apelit pushuan së funksionuari ; aktualisht ka vetëm një gjykatë apeli të juridiksionit të përgjithshëm në Tiranë.

¹⁹Raporti iu dorëzua Parlamentit më 29 prill 2024.

²⁰Në vitin 2023, për Gjykatën e Tiranës mbetën për t'u emëruar 67 gjyqtarë; 11 në Gjykatën e Elbasanit (ku 30% e gjyqtarëve ishin në vend).

Për dy gjykatat administrative të shkallës së parë (në Tiranë dhe Lushnjë), numri i përgjithshëm i çështjeve në pritje u rrit në 7615 në vitin 2023 (5584 në 2021; 7352 në 2022). Norma e likuidimit ishte 91.25% në Tiranë dhe 87% në Lushnjë; Kohëzgjatja mesatare e gjykimeve ishte 292.2 ditë në Lushnjë dhe 217.3 ditë në Tiranë. Ngarkesa e çështjeve është e përqendruar kryesisht në gjykatën e Tiranës (80% e ngarkesës totale të çështjeve), ku ngarkesa e punës për gjyqtar është gjithashtu shumë më e lartë. Përqindja e gjyqtarëve efektivist në detyrë ishte 65% (23 gjyqtarë nga 36 në organikë).

Gjykata e Shkallës së Parë të Posaçme për Korrupsion dhe Krim të Organizuar kishte një kohëzgjatje mesatare të gjykimeve prej 16 ditësh dhe numri i çështjeve të papërfunduara për vitin 2023 ishte 152 (krahasuar me 181 çështje në vitin 2022).

- Raporti i CEPEJ për ciklin e vlerësimit 2024 (të dhënat 2022) : CEPEJ theksoi se verifikimi ka pasur ndikim në numrin e gjyqtarëve, kohëzgjatjen e gjykimeve dhe normën e likuidimit (që ishte nën 100% për gjykatat e shkallës së parë dhe mirë nën 100% për rastet e shkallës së dytë)²¹. Komisioni Evropian në kapitullin e raportit të tij për Sundimin e së Drejtës për Shqipërinë për vitin 2024, theksoi se kohëzgjatja e gjykimeve dhe numri i madh i çështjeve të papërfunduara janë për shkak të vendeve vakante në sistemin gjyqësor dhe shpërndarjes së pabarabartë të çështjeve ndërmjet gjykatave.

5) Mjeti përshpejtues dhe kompensues

Që nga nëntori 2017, në Shqipëri ka funksionuar një mjet i ri përshpejtues dhe kompensues për zgjatjen e tepërt të proceseve gjyqësore²². Faza e parë e mjetit juridik është një kërkesë për të gjetur një shkelje të kërkesës për kohë të arsyeshme (vetëm nga një nivel juridiksioni); nëse gjykata kompetente konstaton një fakt të tillë, mund të urdhërojë përshpejtimin e procedurës. Kërkesa shqyrtohet nga gjykata e cila është më e lartë se ajo që është përgjegjëse për gjatësinë ose nga një formacion tjetër i GjL²³. Faza e dytë e mjetit juridik lejon kërkesën e kompensimit për shkeljen e përcaktuar tashmë të kërkesës për afat të arsyeshëm; Kërkesa për dëmshpërblim duhet të paraqitet në gjykatën e shkallës së parë, e cila e shqyrton atë brenda tre muajve.

Në vendimin e saj të vitit 2022 për *Bara dhe Kola*, Gjykata Evropiane konstatoi se mjeti juridik ishte efektiv në parim, por kishte qenë joefektiv në rrethanat e çështjes pasi procedurat e vonuara përpara GjL nuk ishin përshpejtuar dhe kërkesa për përshpejtimin e tyre kishte mbetur pa përgjigje për më shumë se tre vjet.

Autoritetet informuan se për periudhën janar 2022 – nëntor 2023, në GjL janë paraqitur gjithsej 127 kërkesa për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm (76 në 2022; 51 në 2023), nga të cilat 95 janë shqyrtuar dhe katër janë dhënë. Për të njëjtën periudhë, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm janë depozituar gjashtë kërkesa për konstatim të shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtim, disa prej të cilave janë rrëzuar ose pushuargjykimi; ka pasur edhe dy kërkesa për dëmshpërblim. Gjatë periudhës 2022-2023 janë paraqitur gjithsej 10 kërkesa për dëmshpërblim në gjykatat e shkallës së parë për shkelje të afatit të arsyeshëm; katër u dhanë dhe pjesa tjetër u pushua për shkak të mosparaqitjes së palëve ose për mungesë juridiksioni.

Analiza nga Sekretariati

Për sa i përket masave individuale

Nuk nevojiten masa të mëtejshme individuale në rastet *Lacej dhe të Tjerët*, *Mulla, Zeqo dhe Seat Sh.PK*, *Hamitaj, Vicksoria Sh.P.K dhe Vjola Sh.PK dhe De Sh.PK*. ku gjykimi ka përfunduar dhe është paguar shpërblimi i drejtë dhe në çështjen *Gjonboçari dhe të Tjerët*, ku është miratuar një vendim administrativ për zbatimin e vendimit të gjykatës përkatëse vendase dhe është paguar edhe shpërblimi i drejtë. I propozohet Komitetit që të mbyllë këto çështje të përsëritura dhe të miratojë një rezolutë përfundimtare.

Nuk nevojiten masa të mëtejshme individuale në lidhje me ankimin *Bara* (rasti *Bara dhe Kola*), ku procedura ka përfunduar. Për sa i përket gjykimeve në ankimin *Kola*, çështjen *Luli dhe të Tjerët* dhe çështjen *Kokalari*, priten informacione për përfundimin e gjykimeve të brendshme dhe, sipas rastit, përshpejtimin e tyre. Sa i përket çështjes së fundit *Iliria S.R.L*, ende priten informacione për pagesën e

²¹ Për më shumë detaje shihni raportin e CEPEJ për ciklin e vlerësimit 2024 (të dhënat 2022). Shih edhe raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë të vitit 2023 .

²² Ky mjet zbatohet për hetimet, procedurat gjyqësore penale, civile dhe administrative dhe procedurat përmbartimore, por jo për procedimet para organeve administrative, për të cilat autoritetet konsiderojnë se garancitë e tjera të rishikimit legjislativ dhe gjyqësor janë të mjaftueshme.

²³ Neni 399/6 i Kodit të Procedurës Civile Shqiptare parashikon se gjykata kompetente për të shqyrtuar kërkesat për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm në proceset civile, penale dhe administrative është: gjykata e apelit (nëse procesi është në pritje në shkallë të parë); GjL (nëse proceset janë në pritje përpara një gjykate të apelit) dhe një formim tjetër i KD (nëse proceset janë në pritje përpara një formimi të GjL).

shpërblimit të drejtë.

Për sa i përket masave të përgjithshme

a) Zgjatja e tepert e procedurave

Siç u theksua më parë, përpjekjet e autoriteteve për të finalizuar procesin e vetingut, përparimin me emërimet në drejtësi dhe uljen e numrit të çështjeve të prapambetura kanë qenë dhe mbeten vendimtare për funksionimin e sistemit gjyqësor.

- Kohëzgjatja e gjykimeve dhe çështjet e prapambetura

Është shumë pozitive që Gjykata Kushtetuese aktualisht nuk ka çështje të prapambetura dhe kohëzgjatja e gjykimeve duket e arsyeshme. E njëjta gjë duket të jetë edhe për Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsion dhe Krim të Organizuar dhe Gjykatën Speciale të Shkallës së Parë për Korrupsion dhe Krim të Organizuar.

Është gjithashtu inkurajuese që Gjykata e Lartë ka pasur norma shumë të larta të likuidimit për 2022 dhe 2023, që do të thotë se sasia e konsiderueshme e mbetur e saj tani ka filluar të zvogëlohet dhe se ajo ka një politikë të shqyrtimit më të shpejtë të çështjeve prioritare dhe ka përmirësuar disa praktika. Megjithatë, është shqetësues fakti se kohëzgjatja mesatare e gjykimeve mbetet shumë e lartë dhe se kjo gjykatë aktualisht shqyrton çështjet nga viti 2016-2018, gjë që tregon nevojën për përpjekje të vazhdueshme për të përshpejtuar normën e likuidimit të çështjeve të prapambetura.

Në të kundërt, norma e ulët e likuidimit, kohëzgjatja mesatare e konsiderueshme e gjykimeve dhe numri në rritje i çështjeve të prapambetura në gjykatat e shkallës së dytë të juridiksionit të përgjithshëm ose administrativ duket shqetësuese. Situata në të paktën disa prej gjykatave të shkallës së parë është gjithashtu ende shqetësuese, siç dëshmohet nga rritja e numrit të çështjeve të prapambetura të gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykatave administrative.

- Masat e miratuara ose të parashikuara

Situata e mësipërme duket për shkak (edhe sipas të dhënave të BE-së të datës 30 tetor 2024 ²⁴nga numri i lartë i vendeve vakante të gjyqtarëve në gjykatat e apelit dhe vendet vakante të shkallës së parë (kryesisht në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm), të cilat janë rezultat i verifikimit ende në vazhdim procesi dhe ritmi me të cilin zhvillohen emërimet në drejtësi.

Në këtë drejtim, ndërkohë që pothuajse përfundimi i procesit të vetingut në shkallën e parë është inkurajues, duket e rëndësishme rritja e ritmit të gjykimeve në apel, për të siguruar përfundimin e vetingut përpara afatit të qershorit 2026 sipas parashikimit të përcaktuar në Kushtetutë.

Përsa i përket emërimeve në drejtësi, është inkurajuese që Gjykata Kushtetuese dhe GjL funksionojnë tashmë në përbërje të plotë, që autoritetet po përparojnë me emërimet dhe kanë plane për të plotësuar kolegjet e plota për disa nga gjykatat më të mbingarkuara. Megjithatë, zënia e vetëm 60 % e pozicioneve të gjyqtarëve në gjykata dhe pozicionet e shumta të punonjësve të administratës gjyqësore që mbeten vakante janë shqetësuese, aq më tepër që parashikimet e KLGJ-së tregojnë se nivelet e plota të personelit nuk do të arrihen para vitit 2028 apo më vonë.

Prandaj, autoritetet duhet të ftohen të përdorin të gjitha mjetet e nevojshme për përshpejtimin e emërimeve në drejtësi, duke përfshirë edhe fonde buxhetore shtesë. Duket gjithashtu e rëndësishme të sqarohet nëse parashikohet të ndërmerren hapa për të siguruar një numër të mjaftueshëm të hyrjeve në Shkollën e Magjistraturës, ose masa kalimtare (p.sh. rritja e numrit të mbështetjes nga punonjësit e administratës gjyqësore), si dhe për shpërndarjen adekuate të emërimeve në drejtësi, ngarkesën e punës dhe mbështetje nga stafi i administratës gjyqësore për gjykatat më të mbingarkuara.

Ndërkohë që mbeten shumë sfida, janë zbatuar masa të rëndësishme dhe shpesh komplekse (p.sh. një reformë e hartës gjyqësore dhe emërimi i këshilltarëve ligjorë) ose janë në vazhdim (një strategji për reduktimin e çështjeve të prapambetura, puna në sistemet e menaxhimit të çështjeve, puna për përmirësimin e praktikave, etj.), të cilat mund të përmirësojnë efikasitetin e gjykatave në pritje të plotësimit të tyre me gjyqtarë. Për të lejuar një vlerësim të plotë, autoritetet mund të inkurajohen të japin informacion të detajuar mbi këto zhvillime dhe ndikimin e tyre. Ata gjithashtu mund të inkurajohen të ofrojnë analiza të hollësishme mbi zbatimin dhe ndikimin e ndryshimeve legjislative të miratuara më parë që synojnë

²⁴Komisioni Evropian (2024), Raport Vjetor për Shqipërinë, cituar më sipër.

reduktimin e çështjeve të ridërguar përgjykim në çështjet civile dhe penale.

Për sa i përket të gjitha aspekteve të mësipërme, është e nevojshme që autoritetet të vazhdojnë të paraqesin informacion të detajuar statistikor për emërimet e gjyqtarëve dhe stafit mbështetës; çështjet e prapembetura, normat e likuidimit, kohëzgjatja mesatare e gjykimeve dhe koha e gjykimit për të gjitha nivelet e gjykatave dhe për kategoritë kryesore të çështjeve, në gjykata ose kategori të çështjeve ku ekzistojnë vështirësi të mëdha, si dhe të dhëna të krahasueshme për disa vite për ridërgimin e çështjeve në gjykimet civile dhe penale.

Së fundi, i propozohet Komitetit të mirëpresë dhe inkurajojë angazhimin e autoriteteve në aktivitetet e bashkëpunimit, veçanërisht projektin e përbashkët të Bashkimit Evropian/Këshillit të Evropës “Forcimi i Cilësisë dhe Efikasitetit të Drejtësisë në Shqipëri” (SEJ IV).

b) Mjetet ligjore efektive të brendshme

Numri i përgjithshëm i kërkesave të paraqitura dhe, më e rëndësishmja, i kërkesave të pranuar duket mjaft i ulët për një periudhë dyvjeçare, duke pasur parasysh kohëzgjatjen mesatare shumë të lartë të procedurave para GJD-së dhe gjykatave të tjera. Informacioni për arsyet për refuzimin e kërkesave janë gjithashtu të paplota në disa aspekte dhe është e paqartë nëse disa kërkesa kanë mbetur pa përgjigje.

I propozohet Komitetit që t’u kërkojë autoriteteve të ofrojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse që përmban të dhëna të zbërthyera të numrit të kërkesave të paraqitura dhe miratuara për nivelet e ndryshme të gjykatave dhe për çdo fazë të mjetit ligjor: a) për fazën e gjetjes së shkeljes të kërkesës për kohë të arsyeshme dhe përshpejtimi dhe b) për fazën e kompensimit. Autoritetet gjithashtu duhet të paraqesin informacion të detajuar mbi arsyet e rrëzimit të kërkesave për të konstatuar një shkelje të kërkesës së afatit të arsyeshëm (dhe përshpejtimin) dhe kërkesave për kompensim, si dhe shembuj të vendimeve gjyqësore ku kërkesat përkatëse janë miratuar ose hedhur poshtë.

TË DELEGUARIT

Vendime

CM/Del/Dec(2024)1514/H46-1

5 dhjetor 2024

Takimi i 1514-të, 3-5 dhjetor 2024 (DH)

Të Drejtat e Njeriut

H46-1 Grupi Luli dhe të Tjerët kundër Shqipërisë (Kërkesa Nr. 64480/09)

Monitorimi i ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane

Dokumentet e referencës

[CM/Notes/1514/H46-1](#)

Vendime

Të deleguarit

1. rikujtuan se çështjet e ekzaminuara kanë të bëjnë me zgjatjen e tepërt të procedurave gjyqësore në çështjet civile dhe penale dhe mungesën e mjeteve efektive të brendshme juridike në këtë drejtim;

Për sa i përket masave individuale

2. shënuan se nuk nevojiten masa të mëtejshme individuale në *Gjonboçari dhe të tjerët, Lacej e të tjerë, Mulla, Zeqo dhe Seat Sh.PK, Hamitaj, Vicktoria Sh.P.K dhe Vjola Sh.P. K. dhe De Sh.P. K.* çështje të miratuara me Rezolutën Përfundimtare CM/ResDH(2024)329;

3. ftuan autoritetet të japin informacion mbi pagesën e shpërblimit të drejtë në rastin e fundit *Iliria SRL* dhe mbi gjendjen e procedimeve në lidhje me ankimin Kola nga çështja *Bara dhe Kola*, çështjet *Kokalari* dhe *Luli e të Tjerët* dhe, sipas rastit, të marrë masa për të përshpejtuar çdo gjykim në pritje;

Për sa i përket masave të përgjithshme

4. mirëpritën informacionin që tregon se gjykimet para Gjykatës Kushtetuese duket se janë përfunduar brenda një kohe të arsyeshme dhe se numri i konsiderueshëm i çështjeve të prapambetura në Gjykatën e Lartë ka filluar të zvogëlohet; megjithatë vënë në dukje me shqetësim rritjen e numrit të çështjeve të prapambetura dhe kohëzgjatjen mesatare të lartë të gjyimeve në shumicën e gjykatave të shkallës së dytë dhe sfidat që ende ndikojnë në punën e disa prej gjykatave të shkallës së parë, lidhur me përqindjen e lartë të vendeve vakante për gjyqtarë dhe personel tjetër;

5. përshëndetën, në këtë kuadër, përfundimin e afërt të vetingut në shkallën e parë; u bënë thirrje autoriteteve të sigurojnë përfundimin e gjyimeve të apelit në çështjet e vetingut përpara afatit kushtetues të qershorit 2026;

6. përshëndetën më tej që Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë funksionojnë në përbërje të plotë dhe vënë në dukje me interes progresin e bërë në plotësimin e vendeve vakante të gjyqtarëve; ftuan autoritetet të përdorin të gjitha mjetet për të përshpejtuar emërimet gjyqësore, duke përfshirë fondet shtesë buxhetore dhe për të sqaruar nëse hapa shtesë janë të nevojshëm për të siguruar pranime të mjaftueshme në Shkollën Kombëtare të Magjistraturës, ose ndonjë masë kalimtare; gjithashtu i ftuan ato të sigurojnë shpërndarjen e duhur të emërimeve të gjyqtarëve, ngarkesën e punës dhe mbështetjen nga stafi i administratës gjyqësore për gjykatat më të mbingarkuara;

7. vënë në dukje gjithashtu me interes masat e rëndësishme dhe komplekse të zbatuara (si reforma e hartës gjyqësore) ose në proces (si p.sh. strategjia për uljen e çështjeve të prapambetura dhe punën në

sistemet e menaxhimit të çështjeve), të cilat mund të përmirësojnë efikasitetin e gjykatave në pritje të plotësimit të stafit të tyre me gjyqtarë;

8. mirëpritën dhe inkurajuan angazhimin e autoriteteve në aktivitetet e bashkëpunimit, veçanërisht projektin e përbashkët të Bashkimit Evropian/Këshillit të Evropës “Forcimi i Cilësisë dhe Efikasitetit të Drejtësisë në Shqipëri” (SEJ IV);

9 . ftuan autoritetet të paraqesin informacion për të gjitha aspektet e mësipërme deri më 31 gusht 2025, duke përfshirë informacionin përkatës statistikor dhe informacionin e detajuar mbi funksionimin e mjeteve juridike të brendshme, duke marrë parasysh pyetjet dhe aspektet e identifikuara në analizën e Sekretariatit.

Rezoluta CM/ResDH(2024)329
Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut
Shtatë çështje kundër Shqipërisë

(Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 5 dhjetor 2024
në mbledhjen e 1514-të të Deleguarve)

Kërkesa	Çështja	Vendimi i	Përfundimtar në
10508/02	GJONBOÇARI E TË TJERËT	23/10/2007	31/03/2008
22122/08	LACEJ DHE TË TJERA	29/09/2022	29/09/2022
72348/11	MULLA	06/07/2023	06/07/2023
61445/12+	ZEQO DHE SEAT SH.PK	22/06/2023	22/06/2023
11254/11	HAMITAJ	20/07/2023	20/07/2023
31018/09	VICKTORIA SH.PK	22/02/2024	22/02/2024
18076/12	VJOLA SH.PK DHE DE SH.PK	30/01/2024	30/01/2024

Komiteti i Ministrave, sipas kushteve të nenit 46, paragrafi 2, i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, i cili parashikon që Komiteti monitoron ekzekutimin e vendimeve përfundimtare të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: “Konventa” dhe “Gjykata”),

Duke pasur parasysh vendimet e formës së prerë të përcjella Komitetit nga Gjykata në këto çështje dhe shkeljet e konstatuara për shkak të zgjatjes së tepërt të procedurave dhe, në çështjen *Gjonboçari dhe të Tjerët*, gjithashtu moszbatimi i një vendimi të formës së prerë dhe mungesa e mjeteve efektive juridike (shkelje të neneve 6 § 1 dhe 13) ;

Duke rikujtuar detyrimin e shtetit të paditur, sipas nenit 46, paragrafi 1, të Konventës, për t’iu përmbytur të gjitha vendimeve të formës së prerë në çështjet në të cilat ai ka qenë palë dhe se ky detyrim përfshin, mbi dhe përtej pagesën e çdo shume të dhënë nga Gjykata, miratimi nga autoritetet e shtetit përgjegjës, kur kërkohet:

- masat individuale për t’i dhënë fund shkeljeve të konstatuara dhe për të fshirë pasojat e tyre në mënyrë që të arrihet sa më shumë që të jetë e mundur *restitutio in integrum* ; dhe
- masat e përgjithshme për parandalimin e shkeljeve të ngjashme;

Pasi ka ftuar qeverinë e shtetit të paditur për të informuar Komitetin për masat e mara për të përmbushur detyrimin e sipërpërmendur;

Pasi ka shqyrtuar informacionin e dhënë nga qeveria që tregon masat e miratuara për t’i dhënë efekt vendimeve, duke përfshirë informacionin e dhënë në lidhje me pagesën e shpërblimit të drejtë të dhënë nga Gjykata (shih dokumentin DH-DD(2024)1210) ;

Duke pasur parasysh se çështja e masave individuale është zgjidhur, duke qenë se procedurat kanë përfunduar në çështjet *Lacej e të Tjerët*, *Mulla*, *Zeqo dhe Seat Sh.P.K* , *Hamitaj*, *Vicktoria Sh.P.K* , dhe *Vjola Sh.P.K dhe De Sh.P.K* tashmë që përpara vendimeve të Gjykatës Evropiane dhe shpërblimit të drejtë, dhe për çështjen *Gjonboçari dhe të Tjerët* është miratuar një vendim administrativ për zbatimin e vendimeve përkatëse të brendshme, dhe është paguar edhe shpërblimi i drejtë;

Duke rikujtuar në lidhje me çështjen *Gjonboçari dhe të Tjerët* se masat e përgjithshme përkatëse të kërkuara në përgjigje të shkeljes lidhur me moszbatimin e një vendimi gjyqësor nga ish-Komiteti i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, janë shqyrtuar në kuadër të grupit të çështjesve *Manushaqe Puto* (kërkesa nr. 604/07), i cili u mbyll me Rezolutën Përfundimtare (CM/ResDH(2018)349) ;

Duke rikujtuar se çështja e masave të përgjithshme të kërkuara në përgjigje të mangësive të identifikuar nga Gjykata vazhdon të monitorohet në grupin e çështjeve *Luli dhe të Tjerët* gjithashtu në dritën e gjetjeve të Gjykatës në këto çështjeve, dhe se mbyllja e kësaj çështjeje nuk paragjykon në asnjë mënyrë vlerësimin e masave të përgjithshme të kërkuara nga ana e Komitetit;

Duke qenë i bindur se të gjitha masat e kërkuara nga neni 46, paragrafi 1, janë miratuar,

SHPALL se ka ushtruar funksionet e saj sipas nenit 46, paragrafi 2, të Konventës në këto çështje;

VENDOS të vazhdojë të monitorojë miratimin e masave të përgjithshme të nevojshme në lidhje me zgjatjen e tepërt të procedimeve në grupin e çështjeve *Luli dhe të Tjerët* ; dhe

VENDOS të mbyllë ekzaminimin e këtyre çështjeve.